



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



KATEDRA JEAN MONNET

EEAABAC

EU ENLARGEMENT AND ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

SHKOLLA VERORE

Legjislacioni dhe institucionet e BE-së për profesionistët e së ardhmes

11 KORRIK – 15 KORRIK 2023

Nga Roma në Lisbonë: historiku kushtetues i BE-së: zhvillimet institucionale dhe zgjeruese në fokus

Prof. Asoc. Dr. Arbër Gjeta

Chair Jean Monnet – EEAABAC
Departamenti i së Drejtës – UNIEL

- E drejta kushtetuese e Bashkimit Evropian nuk është rezultat i një instrumenti të vetëm juridik (Traktati).
 - Rishikimet e ndryshme të traktateve kanë ndryshuar tekstet fillestare, si dhe kanë shërbyer si bazë për tekste të tjera që ndërthuren me të.(Traktati I Amsterdimit).
 - Konteksti I bashkimit të shteteve evropiane është trajtuar nga autorë të ndryshëm si I nevojshëm për paqen dhe begatinë e Evropës
- Etapat kryesore të ndërtimit komunitar janë ndarë në disa pjesë
 - Në vitin 1948 Kongresi I Hagës në një mesazh drejtuar Evropianëve bënte thirrje për një Bashkim të pranuar lirisht nga shtetet evropiane , që shërbeu si shtysë për lindjen e organizatave evropiane të themeluara sipas modelit klasik të bashkëpunimit ndërqeveritar
 - U krijuan organizata të ndryshme që përkonin me kuadre të ndryshme , ku në planin ekonomik kemi organizata si OEBE që më pas u bë OBZHE.
 - Në planin ushtarak BEP dhe NATO.
 - Në planin politik Këshilli Evropian.

Krijimi i Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Celikut

- Organizata e parë komunitare për integrim, sektorialë e cila ka të bëjë vetëm me një degë të vecantë të ekonomisë
- Paraqitet si hapi I parë drejtë unifikimit gjithnjë e më të gjerë të Evropës. E krijuar nga Traktati I Parisiti(18 prill 1951) për një kohëzgjatje prej 50 vjetësh.
- Pushteti ne pjesën më të madhe i përket Autoritetit të Lartë të pavarur nga Shtetet (*Komuniteti supranacial*) .
- Organe të tjera si : Këshilli i posacëm i Ministrave, Gjykata e Drejtësisë dhe Asambleja

Dështimi i Komunitetit Evropian për Mbrojtjen

- Dështimi i parë i ndërtimit evropian.
- Shkak ishte riarmatimi gjerman dhe përfshirja e tij në kuadrin evropian
- Projekti për krijimin e KEM , u refuzua nga shteti francez dhe kto projekte më pas dështuan
- Në vitin 1970 do të rifillojë përpilimi i një politike të jashtme të përbashkët që do të përmbante elementë sigurie në formën e bashkëpunimit politik evropian

Rifillimi

- Konferenca e Mesinës(1955) ngarkoi një grupë të kryesuar nga belgu Paul-Henri Spaak për përgatitjen e një raporti që do të përbënte bazën e krijimit të dy komuniteteve të reja.
 - Njëri do të mbulonte tërësinë e fushes ekonomike, Komuniteti Ekonomik Evropian, dhe tjetri sektorial, Komuniteti Evropian për Energjinë Atomike.
- Qëllimi kryesor I Komunitetit Evropian ishte krijimi I një tregu të brendshëm pa kufij që karakterizohej nga qarkullimi I lirë I personave,mallrave,shërbimeve dhe kapitaleve.
 - Ky objektiv plotesohej nga përpilimi i politikave të përbashkëta.
 - Vitet e para të këtij Komuniteti Evropian ishin të pasura me debate politike.
 - Plani Fouchet- parashikonte një Bashkim që të synonte një politike të jashtme të përbashkët dhe një politikë të përbashkët për mbrojtjen.
 - Përgjigja ndaj dështimit të këtij plani ishte zhvillimi i bashkëpunimit franko-gjerman mbi bazë të Traktatit të Elysee-se.
 - Krijimi I instrumenteve të para për sigurimin e stabilitetit monetarë.
- Krijimi i Këshillit Evropian në vitin 1974, duke patur si kundërpeshë demokratike vendimin sipas të cilit Parlamenti do të zgjidhej me votim të përgjithshëm dhe të drejtëpërdrejtë

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

AKTI UNIK EVROPIAN

- Me iniciativën e Altier Spinellit , më 1984 u miratua një projekt-traktat për Bashkimin Evropian.
- Parlamenti vinte në pah nevojën për rishikimin themelor të mekanizmit institucional, dhe propozonte mjete për ta realizuar.
- Gjatë Këshillit Evropian të Milanos, në qershor të vitit 1985, në thirrjen e një konference ndërqeveritare për rishikimin e traktateve , ku përfundoi me nënshkrimin e Aktit Unik Evropian.
- Objektivi i Aktit ishte realizimi i tregut të brendshëm deri në 1 janar 1993, dhe i jepte komunitetit mjete për ta arritur këtë objektiv.
- Parashikoi dhe zgjerimin e rasteve të përdorimit të votimit me shumicë të cilësuar dhe rritjes së rolit të Parlamentit Evropian.
- Zgjerimin e kompetencave komunitare.
- Sanksiononte në një tekst juridik praktikën e bashkëpunimit politik dhe zyrtarizonte ekzistencën e Këshillit Evropian.
- Objektivi i paraqitur në hyrje të këtij akti - “ transformimi i marrëdhënieve midis shteteve anëtare në një Bashkim Evropian”

Traktati për Bashkimin Evropian – Traktati Maastricht

- Lëvizja filloi gjatë Këshillit Evropian të Dublinit me 1989 me thirrjen e dy konferencave ndërqeveritare, njëra për Bashkimin Ekonomik e Monetar dhe tjetra për Bashkimin Politik.
- Rezultati i konferencave diktoi krijimin e Traktatit për Bashkimin Evropian
- Traktati diktoi në bashkimin në një të tërë të komuniteteve, Politikën e Jashtme , Sigurinë e Përbashkët si dhe bashkëpunimin në fushën e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme
- Cështjet për Bashkimin trajtohen në një kuadër institucional të përbashkët
- Bashkimi strukturohet në tri shtylla të vecanta: Komuniteti, Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët dhe Drejtësisë, si dhe Punët e Brendshme
- Në fushën komunitare kemi krijimin e Bashkimit Ekonomik e Monetar (euro), krijimi i politikave të reja, përdorimi i parimit të subsidiaritetit për të rregulluar ushtrimin e kompetencave komunitare

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

Traktati i Amsterdimit - 1997

- Traktati I Matrihtit parashikonte hapjen e një konference të re ndërqeveritare.
- Konferenca u përgatit me anë të një raporti të një grupi reflektimi të kryesuar nga ministri spanjoll ëestendorp.
- Rezultati I negociatave iu nënshtrua nënshkrimit të shteteve anëtare, në Amstërdam.
- Nënshkrimi I traktatit të Amstërdamit lejoi hapjen e procesit të zgjerimit të Bashkimit më tej.
- Zgjerimi kërkonte që të rishikoheshin disa politika të brendshme të komunitetit për ti përshtatur me këtë zgjerim.

Traktati i Nices - 2000

- Iu kushtua cështjes së ponderimit të votave në Këshill, me qëllim që të garantojnë për cdo vendim mbështetjen e shteteve anëtare që përfaqesojnë një shumicë të madhe të popullsisë.
- Përcaktoi përbërjen e ardhshme të Komisionit mbi bazën e një përfaqësuesi për shtet anëtar
- Zgjeron rastet e përdorimit të shumicës së cilësuar.
- Thjeshtëson përdorimin e bashkëpunimeve të përforcuara duke I zgjeruar ato dhe duke hequr mundësinë e vetos në nivelin e Këshillit Evropian.
- Përmban dispozita që e bëjnë më të efektshme sistemin gjyqësor komunitar, kryesisht nëpërmjet krijimit të juridiksioneve të specializuara. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian

Konventa për të Ardhmen e Evropës dhe Traktati i Kushtetutes për Evropën -2004

- Konferenca Ndërqeveritare miratoi Deklaratën për të Ardhmen e Bashkimit , ku parashikonte progreset e mëvonshme dhe vecanërisht mbajtjen e një konference tjetër ndërqeveritare në vitin 2004.
- Ndër cështjet që shtoheshin për diskutim Konferenca Ndërqeveritare kishte identifikuar ato që lidheshin me përcaktimin e saktë të kompetencave ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare, me statusin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, me thjeshtimin e Traktateve dhe rolin e Parlamenteve kombëtare.
- Këshilli Evropian I Laeken-it miratoi një deklaratë në të cilën paraqiste cështjet kryesore që lidheshin me ndarjen e kompetencave midis Bashkimit dhe Shteteve anëtare, me thjeshtimin e instrumenteve, me mjetet për të siguruar demokraci, efektshmëri dhe transparencë, si dhe rruga që duhet ndjekur për përpilimin e një kushtetute.
- Projekt-konventa thjeshtonte traktatet ekzistuese, I jepte vlerë kushtetuese Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, shtonte rastet e përdorimit të vendimarrjes së përbashkët dhe të shumicës së cilësuar dhe ndryshonte organizimin institucional që u krye në Nisë.
- “Kompleksi I Liliputit” - frika e shteteve të vogla se mos vendi I tyre zvogëlohej si në institucione ashtu edhe në procesin e vendimarrjes
- Shtetet përcaktohen sipas interesave të tyre konkrete dhe jo sipas dendësisë së tyre demografike
- Për të hyrë në fuqi kushtetuta duhej të ratifikoheshin nga të gjithë shtetet anëtare. Ndërkaq një deklaratë shtojcë e aktit të fundit parashikonte që, në rast se katër të pestat e shteteve anëtare do ta ratifikonin dhe nëse disa shtete anëtare do të kishin vështirësi, cështja do ti paraqitej Këshillit Evropian.
- Pas dështimit të KEM-it, dështimi I kushtetutes tregon një lloj ngurrimi për të ndjekur një rrugë të ndryshme nga ajo e integritit funksional.

Traktati i Lisbonës - 2007

- Ndryshon traktatet ekzistuese dhe shuhen aspektet kushtetuese
 - Hiqen simbolet e Bashkimit (himni, flamuri, motoja), titulli i Ministrit të Punëve të Jashtme zëvendësohet me Përfaqësues i Lartë i BE për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë.
 - Kto ndryshime shënojnë braktisjen e metodës “kushtetuese” dhe rikthimin tek metoda komunitare.
 - Në përgjithësi prurjet e Kushtetutës ruhen, ndryshimet institucionale gjithashtu.
- Në traktatin e Lisbonës figurojnë edhe klasifikimi i kompetencave, kalimi në shumicën e cilësuar dhe përgjithësimi i procedurës së bashkvendimarrjes si procedurë legjislative e zakonshme.
- Në pjesën më të madhe shqetësimet kryesore të raportuara nga qeveria irlandeze gjenin zgjidhje në Traktatin e Lisbonës dhe traktatet ekzistuese dhe mjaftonte që autoritetet të jepnin sqarime të mjaftueshme gjatë referendumit që shqetësimet të merrnin fund .
 - Politika fiskale mbetet në varësi të unanimitetit e po kështu edhe masat lidhur me familjen , të cilat varen nga pjesa e traktatit për të cilën Irlanda si dhe Mbretëria e Bashkuar gëzojnë një status të vecantë (opting out).
 - Ky status bën që asnjë nga dispozitat e miratuara në këtë fushë nuk mund të jetë e detyrueshme për këto shtete.
- Në mbledhjen e Këshillit Evropian të 18 dhe 19 qershorit, Kryetarët e Shteteve dhe të Qeverive miratuan një vendim për të cilin u theksua se ishte juridikisht i detyrueshëm dhe plotësisht në përputhje me Traktatin e Lisbonës .
 - Ky tekst duhet parë si një marrëveshje në formë të thjeshtuar midis autorëve të Traktatit të Lisbonës
 - Ky vendim theksonte se Traktati I Lisbonës nuk prekte dispozitat kushtetuese irlandeze lidhur me mbrojtjen e të drejtës së jetës, mbrojtjen e të drejtës familjare dhe mbrojtjen e të drejtave për arsimim, nuk ndryshonte kompetencën e bashkimit në fushën fiskale dhe nuk prekte Politikën e mbrojtjes që ka cdo shtet anëtarë, përfshirë ktu edhe neutralitetin irlandez.
 - Traktati nuk parashikon as krijimin e një ushtrie evropiane e as thirrje për në ushtri.

• Natyra e dinamizmit

- Në themel të dinamizmit evropian qëndron bindja e themeluesve të Komunitetit se krijimi i Bashkimit Politik Evropian do të ishte një proces i vazhdueshëm, që të mbështetej në solidaritete të pjeshme të cilat do të zgjeroheshin gradualisht.
 - Kto ide pasqurohen në hyrje të traktateve si KEQC, KEE, Akti Unik Evropian.
 - Deri në hartimin e projekt-kushtetutës, përmbajtja e Bashkimit të ri nuk ishte shkruar kurrë në një dokument të plotë.
 - Bashkimi do të ishte një lëvizje.
 - Pavendosmëria lidhur me qëllimet ka lejuar kto zhvillime . Ato mund ti paraqiteshin opinionit më shumë si fryt i nevojës, sesa si etapa drejt një objektivit të papërcaktuar.
- Dinamizmi komunitar u shfaq me një thellim gradual të Bashkimit, ende pa u përcaktuar forma përfundimtare që ai duhet të merrte, u desh të priteshin negociatat e Traktatit të Nisës që të kuptohej se arkitektura e Bashkimit duhej të përcaktohej në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme , më qëllim që pas zgjerimit ai të mund të funksiononte në mënyrë koherente.
 - Kjo coi në krijimin e Konventes për të Ardhmen e Evropës dhe në debate për Kushtetutën e Bashkimit.
 - Kjo kushtetutë përfaqëson përfundimin e përkohshëm të përpjekjes së filluar gjate krijimit të KEQC-it, por përmban elemente të një dinamizmi të ri

• Rastet e dinamizmit

- Ekziston një dinamizëm nga vetë Traktati .
 - Dispozitat fillestare të traktatit që parashikonin zgjedhjen e mëvonshme të parlamentit me votim të përgjithshëm të drejtëpërdrejtë, ose ato që lejonin krijimin, në një fazë të mëvonshme, të të ardhurave të komuniteteve, përbëjnë faktorë zhvillimi për komunitetet.
 - Klauzola e nenit 30 të Aktit Unik Evropian, detyronte palët kontraktuese që brenda pesë vitesh nga hyrja në fuqi e tekstit të shqyrtonin nevojën për rishikimin e tij.
 - Neni I Traktatit të Bashkimit Evropian që parashikonte një konferencë për rishikimin e disa prej dispozitave të tij në 1996.
- Ekziston gjithashtu një dinamizëm i lindur nga praktika e institucioneve pavarësisht nga vëndi që zënë në sistemin institucional, ato kanë qenë të detyruara të bashkëpunojnë për ti lejuar komunitetit të funksionojë.
 - Përtej cdo vështirësie në interpretim, praktika ka njohur edhe zhvillim të kompetencave të institucioneve për të respektuar përmbajtjen e traktateve.
 - Shpesh rishikimet e mëvonshme të traktateve kanë kodifikuar praktikat ekzistuese si , dispozitat e Traktatit për Bashkimin Evropian për krijimin e komisioneve të hetimit.
- Ndonjëherë dinamizmi vepron jashtë Traktatit dhe përdor rrugën ndërqeveritare.
 - Rasti i Këshillit Evropian që u zyrtarizua me futjen e tij në nenin 2 të Aktit Unik Evropian

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

LEGISLATION AND INSTITUTIONS OF THE EU FOR PROFESSIONALS OF THE FUTURE - THE LEGAL CHALLENGES

• Natyra e dinamizmit

- Në themel të dinamizmit evropian qëndron bindja e themeluesve të Komunitetit se krijimi i Bashkimit Politik Evropian do të ishte një proces i vazhdueshëm, që të mbështetej në solidaritete të pjeshme të cilat do të zgjeroheshin gradualisht.
 - Kto ide pasqurohen në hyrje të traktateve si KEQC, KEE, Akti Unik Evropian.
 - Deri në hartimin e projekt-kushtetutës, përmbajtja e Bashkimit të ri nuk ishte shkruar kurrë në një dokument të plotë.
 - Bashkimi do të ishte një lëvizje.
 - Pavendosmëria lidhur me qëllimet ka lejuar kto zhvillime . Ato mund ti paraqiteshin opinionit më shumë si fryt i nevojës, sesa si etapa drejt një objektivit të papërcaktuar.
- Dinamizmi komunitar u shfaq me një thellim gradual të Bashkimit, ende pa u përcaktuar forma përfundimtare që ai duhet të merrte, u desh të priteshin negociatat e Traktatit të Nisës që të kuptohej se arkitektura e Bashkimit duhej të përcaktohej në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme , më qëllim që pas zgjerimit ai të mund të funksiononte në mënyrë koherente.
 - Kjo coi në krijimin e Konventes për të Ardhmen e Evropës dhe në debate për Kushtetutën e Bashkimit.
 - Kjo kushtetutë përfaqëson përfundimin e përkohshëm të përpjekjes së filluar gjate krijimit të KEQC-it, por përmban elemente të një dinamizmi të ri

• Rastet e dinamizmit

- Ekziston një dinamizëm nga vetë Traktati .
 - Dispozitat fillestare të traktatit që parashikonin zgjedhjen e mëvonshme të parlamentit me votim të përgjithshëm të drejtëpërdrejtë, ose ato që lejonin krijimin, në një fazë të mëvonshme, të të ardhurave të komuniteteve, përbëjnë faktorë zhvillimi për komunitetet.
 - Klauzola e nenit 30 të Aktit Unik Evropian, detyronte palët kontraktuese që brenda pesë vitesh nga hyrja në fuqi e tekstit të shqyrtonin nevojën për rishikimin e tij.
 - Neni I Traktatit të Bashkimit Evropian që parashikonte një konferencë për rishikimin e disa prej dispozitave të tij në 1996.
- Ekziston gjithashtu një dinamizëm i lindur nga praktika e institucioneve pavarsisht nga vëndi që zënë në sistemin institucional, ato kanë qenë të detyruara të bashkëpunojnë për ti lejuar komunitetit të funksionojë.
 - Përtej cdo vështirësie në interpretim, praktika ka njohur edhe zhvillim të kompetencave të institucioneve për të respektuar përmbajtjen e traktateve.
 - Shpesh rishikimet e mëvonshme të traktateve kanë kodifikuar praktikat ekzistuese si , dispozitat e Traktatit për Bashkimin Evropian për krijimin e komisioneve të hetimit.
- Ndonjëherë dinamizmi vepron jashtë Traktatit dhe përdor rrugën ndërqeveritare.
 - Rasti i Këshillit Evropian që u zyrtarizua me futjen e tij në nenin 2 të Aktit Unik Evropian

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

LEGISLATION AND INSTITUTIONS OF THE EU FOR PROFESSIONALS OF THE FUTURE - SHKOLLA VERORE

Dinamizmi ne fokusin e shkencave politike

- Vlera e teorive shpjeguese zbehet, ngaqë specifika komunitare pengon cdo krahasim me struktura të të njëjtit tip
- **Dinamizmi ne fokusin e shkencave politike**
 - Analiza e formave të politikave të zhvillimit të Komuniteteve Evropiane për shumë kohë ka vënë përballë nga njëra anë realistët, dhe nga ana tjetër mbështetësit e transformimeve të përgjithshme që cojnë në sistem federal.
 - Secila ide mbart arritjet dhe të metat e saj, sidomos në fushën institucionale
 - Për tu realizuar kalimin e vrullshëm të Komunitetit në një formë shtetërore federale, duheshim kushte të vecanta, kryesisht një presion i jashtëm shumë i fortë, që të nxitej kërkesa popullore dhe që shtetet anëtare të hiqnin dorë nga sovraniteti i tyre.
 - Aderimi i shteteve të Evropës qendrore nxiti vetëm vullnetin për përshtatjen e institucioneve dhe të politikave, dhe jo për ndryshim të përgjithshëm të komunitetit.
 - Kushtetuta është vazhdimësi e komuniteteve
 - *Janë bërë rishikime të pjesshme*- traktati për çështjet buxhetore (rishikimi më i gjerë i futur nga Akti Unik Evropian), traktatet e Amstërdamit dhe të Nisës e transformuan bashkimin dhe i hapen rrugën reformave të parashikuara nga traktati i Lisbonës.
 - Rëndësia në këto rishikime të pjesshme qëndron në faktin se ato konsolidojnë arritjet e praktikës.
 - Në praktikë institucionet kryejnë rregullime brenda kuadrit të sistemit.
 - Gjykata kujdeset që të ruajë ekuilibrin institucional
 - Kto janë rezultat i praktikës njëpalëshe të një institucioni, ose i një marrëveshjeje midis institucioneve
 - Faktori kohë luan rol të rëndësishëm në formimin e konsensusit për reformat.
 - Ndodh që një numër praktikash të jetojnë gjatë, "repressive", sic është rasti i të drejtës së vetos të vendosur nga Kompromisi i Luksemburgut. Ky kompromis nuk ka asnjë ekzistencë juridike dhe që prej Aktit Unik Evropian, nuk ka shërbyer si referencë, por ekzistenca e tij përmendet rregullisht nga disa shtete anëtare.

Krijimi i Bashkimit Evropian nga Traktati i Mاستrihtit e kishte ndërlikuar shumë arkitekturën komunitare

- Autorët e traktatit nuk kishin dashur ti jepnin formë përfundimtare bashkimit , nga ku emërtimi i zgjedhur konceptohej se kishte karakter përparimtar që percaktohej në hyrje, në kuptimin e perspektivës së etapave të mëvonshme që do të duhet të kapërcehen, me qëllim që bashkimi të ecë përpara
- Neni 1 paragrafi 3 i TBE(nuk ekziston më në versionin fillestar) thoshte se bashkimi ka për mision të organizojë në mënyrë koherente dhe solidare marrëdhëniet midis shteteve anëtare dhe popujve të tyre
 - Imazhi i përdorur shpesh për strukturën e bashkimit ishte me tri shtylla: shtylla komunitare, shtylla kushtuar politikës së jashtme dhe shtylla kushtuar drejtësisë dhe punëve të brendshme.
 - Cdo komunitet kishte personalitet juridik , dhe ky fakt në praktikë ka diktuar debate doktrimore
- Hartimi i një traktati të vetëm që do të përfshinte dispozitat e tri traktateve komunitare do të kërkonte që traktatit të ri, e gjithë *acquis Communautaire*, ti nënshtrohej ratifikimit.
 - Deklarata e Aktit Përfundimtar të Traktatit të Amstërdamit parashikonte që punimet për konsolidimin e traktatit të përfundonin dhe që rezultati të publikohej. Detyra u krye dhe ky dokument bashkë me të tjerë shërbeu si bazë për punimet përgatitore të konferencës ndërqeveritare të vitit 2004.
 - Projektkushtetuta e përgatitur nga Konventa për të Ardhmen e Evropës parashikonte shtrirjen e Bashkimit dhe të Komuniteteve në një person të vetëm juridik dhe për pasojë edhe të traktateve.

Traktati I Lisbonës pajtoi perceptimin popullor me realitetin juridik.

- PJSP-ja varet nga një regjim I vecantë dhe nga një proces I vecantë vedimarrjeje
 - Traktati I Lisbonës e shuan Komunitetin Evropian në Bashkimin Evropian.
 - Neni 40 TBE thekson se – zbatimi I PJSP nuk I prek dispozitat e TFBE-se përse u përket procedurave dhe kompetencave të institucioneve të parashikuara nga TFBE-ja nuk I prek dispozitat e TBE-se mbi të njëjtat çështje.
 - Modalitetet sipas të cilave Bashkimi vepronte në rastin e PJSP-se dhe të politikave të parashikuara nga TFBE-ja janë të ndryshme.
 - Pra nuk janë shmangur plotësisht mundësitë për konflikte
- Për të shmangur shumëfishimin e institucioneve gjatë hyrjes në fuqi të Traktatit të Romës , Konventa për institucionet e përbashkëta krijoi një asamble dhe një gjykatë për të trija komunitetet
 - Traktati për shkrimin e ekzekutivëve krijoi këshillin dhe një komision të vetëm.
 - Komunitetet e ndryshme në mungesë të shkrirjes së traktateve , kur ndërhyjnë në një fushë të caktuar, ato ndiqnin rregullat e procedurës dhe të përmbajtjes që parashikonte traktati që vepronte në atë fushë.
 - Gjatë negociimit të Traktatit për Bashkimin Evropian, autorët e traktatit ndoqën rrugën për krijimin e një sistemi institucional të përbashkët(të njëjtat institucione të përdorshin njëherësh në kuadrin e titujve V dhe VI të TBE dhe në kuadrin komunitar).
 - Ekzistenca e një kuadri të vetëm institucional ka favorizuar koherencën midis politikave që ndiqen në kuadrin e të trija shtyllave
 - Gjate të njëjtës mbledhje, I njëjti institucion trajtonte çështje që ju përkasin shtyllave të ndryshme, ai duhet të vepronte në mënyrë të tillë që vendimet e marra në kuadrin e njëres prej shtyllave të mos ishin të papajtueshme me ato të miratuara në kuadrin e dy të tjerave.
 - Me paraqitjen që kishte, struktura e bashkimit ishte komplekse dhe e vështirë për tu kuptuar nga publiku I gjerë dhe media.
 - Modalitetet sipas të cilave Bashkimi vepronte në rastin e PJSP-se dhe të politikave të parashikuara nga TFBE-ja janë të ndryshme.
 - Pra nuk janë shmangur plotësisht mundësitë për konflikte

- Traktatet e BE : Marreveshje nderkombetare apo kushtetute?
 - GjED i cileson si “Karta kushtetuese e Komunitetit” (Ceshtja 294/83 Les verts vs. Parlament Europeen, Rec. 1333; Opinioni 1/91 Espace economique europeen, rec. I-6079)
 - Natyra sui generis e BE ne panoramen nderkombetare e afermuar
 - Shtetet antare rregullojne me rend juridik te posatcem marredheniet midis tyre jo sipas se drejtes nderkombetare
 - Roli i GjED eshte thelbesor ne ngritjen e rendit juridik te BE dhe lider per nje process kushtetueshmerie
- Natyra juridike e BE
 - BE nuk ka natyre shteterore (territory, popullsia dhe autoriteti Sovran si elemente te Shtetit)
 - BE nuk eshte organizate nderkombetare
 - GjED ne ceshjen Van gend en Loos e percakton si “rend te ri juridik te te drejtes nderkombetare” – Ceshtja 26/62 pika 3
 - GjED ne ceshtjen Costa vs Enel largohet nga teoria e perkatesise ne te drejten nderkombetare – Ceshtja 6/64 pika 1141
 - Efekti i drejteperdrejte, perparesia ne lidhje me te drejten e shteteve antare jane karakteristikat kryesore te ketij rendi te ri juridik komunitar – Opinioni 1/91 pik I-6079
 - Risi ideja e konceptit te QYTETARISE qe e ben BE rast shume specifik
 - Shtet federal
 - Shtet konfederal



OBJEKTIVAT E BE

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



- Objektivat ekonomike – neni 3
 - Krijimi i tregut te brendshem
- Objektivat politike
 - Neni 2 TBE
 - Parimi i subsidiaritetit
- Vlerat Themeluese
 - Bashkim i se Drejtes (Shtet i se Drejtes)
 - Ceshtja Te gjelberit – mund te ankimohet ne gjykate nje akt i Parlamentit Evropian
 - Respektimi i te drejtave themelore
 - Heshtje fillestare e traktateve
 - Ceshtja Solange I ne Gjermani
 - Perfshirja graduale e te Drejtave te Njeriut ne Traktate
 - Traktati i Lisbones ne nenin 6 i jep Kartes Evropiane te te Drejtave themelore vlere te njejte si traktatet
 - Protokoll per Britanine dhe Polonine
 - BE respekton KEDNj
 - Karta e te Drejtave Themelore te BE
 - Parimi i demokracise – neni 9
 - E ndare demokracia midis Parlamentit dhe Keshillit ne procedure e bashkevendimarrjes
 - Drejtesia sociale – perfshire tani ne nenin 2 TBE dhe nenin 9 TFBE
 - Pluralizmi kulturor
- Themelore ne kuader te procesit te integrimit – Perkojne me kriteret e Kopenhagenit



Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

- Rregullimi në TBE
 - Nenet 2 dhe 49
- Neni 2 TBE – vlerat e BE që duhen përmbushur
 - Bashkimi ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri në të cilën mbisundon pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave.
- Neni 49 TBE – baza ligjore për anëtarësim në BE
 - “Çdo Shtet Europian, i cili respekton vlerat e përmendura në nenin 2 dhe është i angazhuar për nxitjen e tyre, mund të kërkojë të bëhet anëtar i Bashkimit. Parlamenti Europian dhe Parlamentet kombëtare njoftohen për këtë kërkesë. Shteti kërkues ia drejton kërkesën Këshillit, i cili vepron unanimisht, pasi konsultohet me Komisionin dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Europian, i cili vepron me shumicën e deputetëve që e përbëjnë. Merren në konsideratë kushtet e pranueshmërisë të miratuara nga Këshilli Europian.
 - Kushtet e anëtarësimit dhe përshtatjet me Traktatet mbi të cilat është themeluar Bashkimi, që kërkon një anëtarësim i tillë, i nënshtrohen marrëveshjes midis Shteteve Anëtare dhe Shtetit kërkues. Kjo marrëveshje paraqitet për ratifikim në të gjitha Shtetet kontraktuese, në përputhje me kërkesat kushtetuese respektive të tyre.”

Procedurat e zgjerimit te BE dhe perafrimi i legjislacionit

Kuadri normative – kriteret

- Keshilli European percakton kriteret per tu perzgjedhur nga BE
- Kriteret e Kopenhagen (Mbledhja e Keshillit European ne Kopenhagen ne Qershor 1993)
 - Pasja e institucioneve stable qe garantojne demokracine, shtetin e se drejtes, te drejatat e njeriut dhe mbrojne minoritetet
 - Ekonomi tregu funksionale dhe kapacitetin te perballen me konkurrencen e lire dhe forcat e tregut ne BE
 - Mundesine qe te marrin persiper dhe implementojne ne menyre efektive detyrimet e anetaresimit, perfshire qellimin e bashkimit politik, ekonomik dhe monetar.
- Keshilli European i Madridit Dhjetor 1995
 - Te jene te gatshem te zbatojne legjislacionin e BE
 - Te garantojne qe transpozimi I se drejtes se BE ne shtetin e tyre eshte I implementuar dhe zbatohet ne menyre efektive nepermjet nje structure administrative dhe gjyqesore adekuate
- Vleresimi nese kriteret e adesioneve permbushen nga vendi kandidat i takon BE
 - Vleresimi behet duke paramentruar kriteret sipas shteteve me formulen “merit based evaluation” per secalin aplikant

Procedurat e zgjerimit te BE dhe perafrimi i legjislacionit

Procedurat e antaresimit

- Aplikimi i Shtetit
 - Keshilli i BE merr aplikimin dhe informon Parlamentin, Komisionin dhe parlamentet e vendeve antare
- Opinioni i Komisionit Europian
- Marrja e statusit te vendit Kandidat
 - nga Keshilli i BE me unanimitet
- Celja e negociatave
 - Mbas vendimit unanim te Keshillit te BE
 - Nepermjet konferencave nderqeveritare midis qeverive te vendeve te BE dhe Shtetit kandidat
 - Acquis perbehet nga 35 tematika per nje negociim efektiv
 - 35 kapituj negocimi
 - Screening report per cdo njerin nga kapitujt per tu kuptuar qarte progresi ne permbushjen e kriterëve
 - Mbyllja e kapitullit te negociimit ne menyre provizore vetem kur shteti kandidat tregon se ka arritur progresin e nevojshem
 - Adoptimi I acquis ne ate kapitull
 - Monitorim konstant per implementimin e acquis
- Marreveshjet tranzitore
 - Per futjen ne menyre graduale te disa parashikimeve ne nermativen e BE ne shtetin kandidat . Per ti dhene kohe shtetit te adaptohet pa problematika te brendshme
- Aderimi/Antarsimi
 - Traktat qe firmoset kur jane mbyllur negociatat
 - Pranohet nga Keshilli I BE, ok nga Parlamenti Europian
 - Ratifikohet nga shtetet antare
- **Procesi per Ballkanin perendimor si proces i vecante**

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

CHALLENGES



Procedurat e zgjerimit te BE dhe perafrimi i legjislacionit Institucionet – roli i Komisionit

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



- Me rendesi te vecante eshte roli i Komisioni European
 - European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations (DG NEAR)
- Politika e zgjerimit
 - Vendet e Ballkanit perendimor
 - Turqia
 - Gjeorgjia
 - Moldavia
 - Ukraina
- Instrumentat dhe veprimi
 - Koordinimi me kandidatet e BE dhe kandidatet potenciale
 - IPA (Instruments of pre-accession)
 - Ndhme financiare dhe teknike per reforma ne kuader te integrimt
 - Aktualisht IPA III (2021-2027)
 - Baza ligjore per integrimin TRAKTATI
- Objektivat e BE me vendet fqinje dhe kandidatet
 - Paqe dhe stabilitet ne vendet fqinje
 - Permiresimi cilesise se jeteses
 - Rritja e prosperitetit dhe mundesive per bizneset europiane dhe qytetaret
 - Mentorimi, suporti dhe monitorimi i ndryshimeve ne vendet qe kane deshire te aderojne ne BE duke i parametruar me vlerat, ligjet dhe standartet e BE

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



- Kuadri i vecante i procesit të stabilizimit asociimit
 - 3 qelime
 - Stabilizimi I vendeve në aspektin politik dhe kalimi nga tranzicioni në ekonomine e tregut
 - Promovimi I bashkëpunimit rajonal
 - Mundësia për anëtarësim në BE
- Partneritet BE – Ballkani perëndimor
 - Akses në tregun evropian pa dogane
 - Asistencë ekonomike dhe financiare
 - Asistencë për rindërtim, zhvillim dhe stabilizim
 - Marrëveshje të stabilizimit asociimit
 - nisme në 1999 dhe forcuar në summitin e Selanikut në 2003
 - MSA me Shqipërinë në 2006



Procedurat e zgjerimit te BE dhe perafrimi i legjislacionit Integrimi europian – Rasti Shqiperise I

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



- Pre - screening
 - <https://punetejashtme.gov.al/pre-screening/>
- Integrimi ne detaje
 - <https://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/>
- Plani kombetar I integrimit
- Takime nderinstitucionale me BE
- Negociatat e antarsimit
 - Në shqyrtimin analitik të legjislacionit (Screening);
 - Në hapjen dhe zhvillimin e tyre për çdo kapitull të acquis;
 - Në mbylljen e negociatave për çdo kapitull dhe nënshkrimin e Traktatit të Aderimit.



Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



Procedurat e zgjerimit të BE dhe përafrimi i legjislacionit Integrimi evropian – Rasti Shqiperise II

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



- 35 kapituj negociatash
- Struktura e negociatorit
 - Kryenegociatori
 - Komiteti shteteror per integrimin evropian
 - Delegacioni shteteror
 - Grupi negociator
 - Misioni i Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
 - Sekretariati i Integritimit Evropian;
 - Grupet Ndërinstitucionale të Punës;
 - Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian.
- VKM Nr.749 datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”
- VKM Nr.94 datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian”

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



Bibliografi, materiale, dokumenta zyrtare dhe linke për konsultim të mëtejshëm mbi leksionin e sotëm (Reader)

- Bibliografi

- Jacque, J.P. 2010, E drejta institucionale e Bashkimit Evropian, Botimet Papirus, Tirane f. 9-89, 2014, f. 120 – 130
- Bibliografi nga Readeri fillestar

- Ligje, VKM, Dokumenta Zyrtare

- TBE
- TFBE
- Plani kombetar i integritimit
- VKM Nr.749 datë 19.12.2018
- VKM Nr.94 datë 20.05.2019

- Linke të dobishme

- <https://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/plani-kombetar-i-integritimit-pkie/>
- https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/albania_en
- https://european-union.europa.eu/index_en
- https://european-union.europa.eu/institutions-law-budget/institutions-and-bodies/search-all-eu-institutions-and-bodies/council-european-union_en
- https://european-union.europa.eu/institutions-law-budget/institutions-and-bodies/search-all-eu-institutions-and-bodies/court-justice-european-union-cjeu_en

Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



Kontakt:

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Faleminderit për vëmendjen!

Pyetje?

Assoc. Prof. Dr. Av. Arbër Gjeta

Chair JM in EU Law - Department of Law
Faculty of Economy
University of Elbasan

arber.gjeta@uniel.edu.al



Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES